



FËMIJËT DHE PAJISJET DIGJITALE

Si të mbrojmë fëmijët gjatë përdorimit të internetit në pajisjet digjitale

Udhëzim

Për autoritetet arsimore, OJQ-të partnere dhe institucionet që kanë dëshirë t'u ofrojnë fëmijëve pajisje digjitale të sigurta për mësimin në distancë.

Maj 2020

UNICEF Shqipëri



Hyrje

Emergjenca COVID-19 ka ndryshuar mënyrën sesi fëmijët dhe adoleshentët në të gjithë botën po arsimohen, me mësimin në distancë dhe të nxënimit online, që janë kthyer në normalitetin e ri për fëmijët në shkollë pothuajse kudo. Ndërsa fëmijët, mësuesit dhe prindërit filluan përshtatjen e nevojshme, kjo risi nxori në pah edhe pabarazi, rreziqe dhe cenueshmëri të reja si kurrë më parë.

Vetëm në Shqipëri janë prekur 571,566 fëmijë nga mbyllja e institucioneve arsimore. Përvoja e tyre me shkollimin tradicional mori papritmas formë të re falë të nxënimit nëpërmjet teknologjisë, internetit, ekraneve dhe platformave elektronike si zëvendësuese për klasat dhe librat në format të printuar. Ndonëse shumë fëmijë ndoshta u ngazëllyen nga ideja që do të kalonin më shumë kohë 'online', prindërit, kujdestarët dhe mësuesit e tyre e gjeten veten kryesisht të papërgatitur si për aftësitë digjitale ashtu edhe për udhëzime mbi sigurinë online. Qëndrimi të lidhur në internet për më shumë orë nëpërmjet pajisjeve digjitale si për t'u argëtuar dhe për qëllime mësimore do të thotë rritje e ekspozimit të fëmijëve ndaj rreziqeve online.

Për më tepër, politikëbërësit dhe advokuesit e të drejtave të fëmijëve filluan të shqetësohen për pabarazitë e reja që dolën në pah. Mungesa e pajisjeve që mundësojnë lidhjen me internetin në shtëpi, kostot e lidhjes (celulare ose broadband) e shoqëruar me mungesën e aftësive digjitale bazë ka zgjeruar hendekun ndërmjet fëmijëve dhe familjeve që nuk mund të përballojnë këtë shërbim dhe që nuk dinë se si të ndjekin mësimin online dhe pjesës tjetër të popullsisë. Institucionet publike dhe organizatat joqeveritare po mobilizojnë burimet për të bërë të mundur aksesin ndaj pajisjeve digjitale për ata fëmijë familjet e të cilëve nuk mund ta përballojnë lidhjen me internetin, për t'u siguruar që të vazhdojnë të kenë akses në arsim dhe në shërbimet dhe burimet e tjera të bazuara në internet gjatë gjendjes së pandemisë së COVID-19.

Në këtë kontekst, ky udhëzim synon t'i orientojë aktorët përkatës në lidhje me masat dhe hapat e rekomanduar që ata do të duhet të zbatojnë për të siguruar që pajisjet e shpërndara të fëmijët, me qëllim sigurimin e lidhjes në internet do të minimizojnë ekspozimin e fëmijëve ndaj rreziqeve në internet dhe kërcënimeve që lidhen me sigurinë, duke i lejuar ata të maksimizojnë përfitimet e përvojës së tyre në internet.

Udhëzimi do të jetë i dobishëm për autoritetet arsimore, partnerët ose organizatat filantropike, OJF-të, si dhe aktorët e industrisë së TIK-ut që janë të angazhuar në shpërndarjen e pajisjeve digjitale për fëmijë.

Përkufizimi i pajisjes digjitale: Një pajisje digjitale është një pajisje elektronike që mund të marrë, ruajë, përpunojë ose dërgojë informacione digjitale. Në këtë udhëzim, ne u referohemi kompjuterëve personalë, telefonave inteligjentë dhe tabletave si shembuj të pajisjeve digjitale.

Një pajisje digjitale e sigurt për çdo fëmijë

UNICEF Shqipëri këshillon institucionet qeveritare dhe joqeveritare të garantojnë që pajisjet digjitale që u shpërndahen fëmijëve të jenë të projektuara për të qenë të sigurt. Gjithashtu, pajisjet digjitale duhet të jenë miqësore me fëmijët, në mënyrë që ata të jenë në gjendje t'i përdorin lehtë dhe të kuptojnë përmbajtjen dhe të gjitha elementet e pajisjes.

- 1) Faza e prokurimit: Për të minimizuar situatat në të cilat fëmijët mund të përballen me sjellje dhe përmbajtje të dëmshme, elementet e sigurisë duhet të përfshihen në produktet ose shërbimet teknologjike që në fillim. Nëse ju ose kompania juaj po planifikoni të blini pajisje digjitale që do të përdoren nga fëmijët, sigurohuni që kontratat me furnizuesit e TIK-ut të parashikojnë konsiderata të sigurisë në të gjitha pajisjet digjitale, duke përfshirë:
 - a. **Udhëzuesin për përdorimin e pajisjes** të përkthyer në shqip;
 - b. **Kasë mbrojtëse (të papërshkrueshme nga pluhuri, mbrojtëse nga goditjet); xham mbrojtës si dhe kufje** për fëmijët që ju dorëzohen pajisjet digjitale (aksesorë që duhet të blihen së bashku me këto pajisje);
 - c. Dimensioni i ekranit të pajisjes digjitale duhet të jetë së paku 7-inch (17.78 cm) për një përvojë të sigurt;
 - d. Pajisjet digjitale duhet të kenë karikues dhe përshtatës energjie për 220 volt (për përdorim në familjet shqiptare);
 - e. **Aplikacionet mësimore dhe bashkëpunuese të para-instaluar** (sipas udhëzimeve dhe përdorimit të autoriteteve arsimore) duhet të jenë të grupuara në një dosje ose me "shortcut" në desktopin e pajisjes digjitale. Disa shembuj përfshijë:
 - i. Platformat mësimore elektronike: Akademi.al; SchoolMe, etj;
 - ii. Sistemet e menaxhimit të mësimin digjital: Class Dojo, Google Classroom
 - iii. Aplikacionet bashkëpunuese: Zoom, Skype, What's App.
 - f. Pajisjet digjitale duhet të kenë 2 modalitete/llogari të instaluar dhe funksionale: një llogari të mbrojtur me fjalëkalim për prindërit nën emrin "Administrator" dhe një për fëmijën. Nëpërmjet llogarisë së tyre prindërit duhet të jenë në gjendje të menaxhojnë elemente të ndryshme të sigurisë në llogarinë e fëmijës: sa kohë mund të përdorin pajisjen digjitale për një ditë, çfarë mund dhe nuk mund të shohin/luajnë, të menaxhojnë aplikacionet e instaluar, etj. Kur bëhet fjalë për fëmijë më të vegjël, këto cilësime duhet të përfshijnë kontrollin prindëror, pajisje për sigurinë në rrjet dhe aplikacione të projektuara posaçërisht për fëmijët. Masat e tjera mund të përfshijnë vlerësimin e përmbajtjes dhe klasifikimin në mënyrë që fëmijët të mos ekspozohen pa dashje ndaj dhunës ekstreme dhe pornografisë; mjetet e verifikimit të moshës; mjete për raportimin e keqpërdorimit dhe abuzimit; si dhe heqjen dhe bllokimin e përmbajtjes së paligjshme siç janë materialet e abuzimit me fëmijë.
 - g. Sigurohuni që **Antiviruset** të ofrohen për të gjitha sistemet dhe pajisjet, duke përfshirë instalimin, të kenë të paktën 3 vjet garanci, me licencat dhe kodet përkatëse. Antivirusi duhet të sigurojë mbrojtje totale, duke përfshirë mbrojtjen

gjithëpërfshirëse për sistemet dhe duhet të jetë në gjendje të mbrojë kundër kërcënimeve të më fundit - viruset bllok, programet e dëmshme si malware, ransomware, spyware, programe të padëshiruara, etj.

- h. Siguroni **mirëmbajtjen e pajisjes** dhe mbështetje për familjet për të paktën 2 vjet nga dorëzimi te përfituesi (qoftë nëpërmjet një numri kontakti për mbështetje në distancë ose përmes një eksperti për mbështetje në terren).

2) **Lidhja me Internetin:** Për të siguruar një qasje efektive në internet për fëmijët në gjendje vulnerabël, organizatat ose institucionet që blejnë dhe ofrojnë pajisje digjitale duhet të marrin në konsideratë të mbështesin familjet me paketa për lidhjen me internetin si:

- a. Karta SIM të regjistruara paraprakisht në rast se pajisja digjitale punon me 3G-4G (p.sh. tableta). Kartat SIM duhet të caktohen automatikisht vetëm për përdorimin e internetit (ideale do të ishte paketa me 5GB për video, ngarkim materialesh dhe mësim në distancë), ndërsa modaliteti telefonik duhet të jetë i çaktivizuar për të siguruar që familjeve nuk do t'u ngarkohen shpenzime shtesë;
- b. Lidhje interneti që filtron materialet e abuzimit të fëmijëve dhe pornografia për të rriturit (si për internet me brez të gjerë ashtu edhe për Wi-Fi). Një lidhje interneti e filtruar siguron prindërit dhe kujdestarët që interneti që fëmijët po përdorin bllokon aksesin në pornografinë për të rritur dhe ka vendosur në listën e zezë përmbajtje të abuzimit seksual të fëmijëve në ueb. Nisma "[Friendly Wi-Fi](#)" Albania është një shembull i një standardi certifikimi, që në bashkëpunim me Ofruesit e Shërbimit të Internetit mund të sigurojnë që aksesin në internet mbrohet nga përmbajtja e abuzimit seksual të fëmijëve dhe pornografia për të rritur. Formulari i aplikimit për bizneset dhe ofruesit e shërbimeve është i disponueshëm [këtu](#).

3) Udhëzues për Kontrollin Prindëror. Pas finalizimit të produkteve, sigurohuni që prindërve, kujdestarëve dhe mësuesve t'u ofrohen Udhëzues të posaçëm për Kontrollin Prindëror në gjuhën shqipe, duke përfshirë opsione lehtësisht të kuptueshme që ata të mund të shkarkojnë dhe monitorojnë.

Udhëzuesi mund të jetë në formën e broshurave të printuara ose përmes materialeve audio-vizuale dhe duhet të përmbajë të dhënat minimale për prindërit mbi mënyrën se si të:

- hapin adresë email-i;
- bllokojnë faqet e internetit dhe filtrojnë përmbajtje të paligjshme dhe të dëmshme;
- vendosin kufij dhe monitorojnë veprimtaritë e fëmijëve
- menaxhojnë mjetet për kohën e shpenzuar përpara ekranit;
- çaktivizojnë gjurmimin e vendndodhjes;
- lidhin pajisjet digjitale të të gjithë fëmijëve në llogaritë e prindërve, etj.

Shembuj se si të aktivizohen kontrollet prindërore:

1. [Si të aktivizoni SafeSearch në Sistemet Operative Android:](#)
 2. [Përdorni kontrollet prindërore në iPhone-in, iPad-in dhe iPod touch-in e fëmijës tuaj](#)
- 4) Aksesueshmëria: Kur ofroni pajisje digjitale për fëmijët me aftësi të kufizuara siguroni përputhjen e tyre me standardet e aksesit, sipas praktikës më të mirë në teknologjitë ndihmëse¹.

Shembuj:

- Platforma mësimore elektronike për fëmijët me dëmtim të dëgjimit, "I Learn/Unë mësoj" (me pagesë); [Faqja e internetit për individët](#) që nuk dëgjojnë të cilat mund të vendosen si shkurtesa [shortcuts] në desktopin e pajisjes digjitale.
- Aksesueshmëria për individët që nuk shohin mund të sigurohet nëpërmjet pajisjeve digjitale që operojnë me [sistemet IOS](#).

Ky udhëzim është përgatitur në kuadër të programit "Internet më i Sigurt dhe më i Mirë për fëmijët në Shqipëri", i mbështetur nga Fondi 'T'i japim Fund Dhunës'.

¹Teknologji Ndihmëse për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara: një dokument diskutues, OBSH / UNICEF, 2015 UNICEF, I disponueshëm në:

<http://www.unicefinemergencies.com/downloads/eresource/docs/Disability/Assistive-Tech-Web.pdf> ;

Specifikimet e Produkteve Ndihmëse për Prokurimin: <https://at2030.org/at-procurement-workshops/>

Burime të dobishme

Një klikim larg: Përvoja e përdorimit të internetit nga fëmijët në Shqipëri (UNICEF Shqipëri, 2019)
Strategjia Evropiane për Internet më të Mirë për Fëmijët (Komisioni Evropian, 2012)
Siguria e Fëmijëve Online: Sfidat dhe Strategjitë Globale (UNICEF Zyra në Innocenti, 2011)
Aftësitë digjitale për Fëmijët: Eksplorimi i Përcaktimeve dhe Kornizave (UNICEF, 2019)
Udhëzime për Industrinë mbi mbrojtjen e fëmijëve online (ITU dhe UNICEF, 2014)
Friendly WiFi Albania (Faqja në Internet e Friendly WiFi)
Kuiz për fëmijë mbi sigurinë e fëmijëve online (I-Kuiz për fëmijë mbi sigurinë e fëmijëve online)
Manuali "Këshilluesit e vegjël për sigurinë online" (AKCESK dhe UNICEF Shqipëri, 2019)
Aksesi në Shkollë dhe Mjedisi Mësimor, Fizik, informacioni dhe komunikimi (UNICEF, 2014)
Teknologji Ndhmëse për Fëmijët me Aftësi të kufizuara: një dokument diskutimi Specifikimet e Produkteve Ndhmuese për Prokurimin (1, 2) (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 201)
Moduli 1: Të Drejtat e Fëmijës dhe Sektori i TIK-ut (UNICEF, 2019)
Moduli 2: Udhëzimet e Mbrojtjes së Fëmijëve Online për industrinë e TIK-ut (UNICEF, 2019)
Komunikimi për Strategjitë e Zhvillimit për të Mbështetur dhe Fuqizuar Vajzat Adoleshente (UNICEF, 2013)
Përmirësimi i rezultateve të të nxënësve: mundësitë dhe sfidat e TIK-ut për të nxënësit (UNICEF, 2018)
Udhëzues i politikave për fëmijët dhe lidhjet digjitale (UNICEF, 2018)
Një Seri Udhëzuesish për Fillestarë (Faqja e internetit me udhëzuesit për sistemet operative Android, u bë e aksesueshme në maj 2020).